



2229 P.1  
23.12.15

**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRUPI I KËSHILLTARËVE TË PARTISË DEMOKRATIKE**

---

Tirane me, 23.12.2015

**Drejtuar:**               **Z. Erion Veliaj**  
Kryetar  
BASHKIA TIRANË

**Për dijëni:**           **Z. Aldrin Dalipi**  
Kryetar  
Këshilli Bashkiak

**Lënda:**                Kërkesë për dhënie informacioni

I nderuar Z. Kryetar,

Në mbështetje të nenit 29, pika 3, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "*Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*", i ndryshuar, nenit 11, pika 4 të *Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak*, nenit 14, pika 1, shkronja "c" i "*Rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë së Tiranës*", në cilësinë dhe në ushtrim të funksionit të Kryetarit të Grupit të Këshilltarëve të Partisë Demokratike, kerkoj te pajisem me informacionin e detajuar, sipas tabelës bashkëlidhur si dhe dokumentacionin përkatës, në lidhje me sa më poshtë:

1. Nisma “Adopto një çerdhe”:

- 1.1 Cila është procedura e ndjekur për zbatimin e nismës “adopto një çerdhe” baza ligjore mbi të cilën është mbështetur kjo procedure si dhe akti administrativ përkatës (*dokumentacioni perkates*);
- 1.2 Cila është vlera e kesaj nisme dhe cilet janë subjektet që kane perballuar shpenzimet e nevojshme për realizimin e sa më sipër? (*dokumentacioni perkates*);
- 1.3 Cila është marrëdhënia juridike e krijuar ndërmjet Bashkise Tirane dhe subjekteve private, të cilët kanë përballuar shpenzimet në kuadër të sa më sipër? (*dokumentacioni perkates*);
- 1.4 Cilat janë të drejtat dhe detyrimet (financiare dhe jo-financiare) e Bashkise Tiranë dhe subjekteve private që rrjedhin nga marrëdhënia juridike ndërmjet tyre, lidhur me sa më sipër; (*dokumentacioni perkates*)

2. Rehabilitimi i sheshit “Italia” dhe ndërtimin e parkingut në të;

- 2.1 Cila është procedura e ndjekur për zbatimin projektit si më sipër, baza ligjore mbi të cilën është mbështetur kjo procedurë si dhe akti administrativ përkatës (*dokumentacioni perkates*);
- 2.2 Cila është vlera e sa më sipër dhe cili subjekt ka përballuar shpenzimet e nevojshme për realizimin e sa më sipër? (*dokumentacioni perkates*);
- 2.3 Cila është marrëdhënia juridike (kontratë/marrëveshje/etj.) me Bashkinë Tiranë, që rregullon këto shpenzime? (*dokumentacioni perkates*)

3. Punimet/ndërrhyrjet e kryera në rrugën e njohur me emërtimin “Dritan Hoxha”;

- 3.1 Cila është procedura e ndjekur për sa më sipër, baza ligjore mbi të cilën është mbështetur kjo procedurë si dhe akti administrativ përkatës (*dokumentacioni perkates*);
- 3.2 Cila është vlera e punimeve/ndërrhyrjeve dhe cili subjekt ka përballuar shpenzimet e nevojshme për realizimin e sa më sipër? (*dokumentacioni perkates*);
- 3.3 Cila është marrëdhënia juridike e krijuar ndërmjet Bashkise Tiranë dhe subjekteve private, të cilët kanë realizuar kryerjen e punimeve, si më sipër treguar? (*dokumentacioni perkates*)

3.4 Cilat janë të drejtat dhe detyrimet (financiare dhe jo-financiare) e Bashkisë Tiranë dhe subjekteve private që rrjedhin nga marrëdhënia juridike ndërmjet tyre; (*dokumentacioni përkatës*)

4. Festimet e organizuara nga Bashkia Tiranë për festat e 28-29 Nëntorit.

4.1 Cila është procedura e ndjekur për realizimin e festimeve, si më sipër, baza ligjore mbi të cilën është mbështetur kjo procedurë si dhe akti administrativ përkatës (*dokumentacioni përkatës*);

4.2 Cila është vlera e tyre dhe cili subjekt ka përballuar shpenzimet e nevojshme për realizimin e sa më sipër? (*dokumentacioni përkatës*)

4.3 Nëse shpenzimet e përmendura në pikën 4.2, janë përballuar nga subjekte private, cila është marrëdhënia juridike (kontratë/marrëveshje/etj.) me Bashkinë Tiranë, që rregullon këto shpenzime? (*dokumentacioni përkatës*)

4.4 Cilat janë të drejtat dhe detyrimet (financiare dhe jo-financiare) e Bashkisë Tiranë dhe subjekteve private që rrjedhin nga marrëdhënia juridike ndërmjet tyre; (*dokumentacioni përkatës*)

Duke e vlerësuar si thelbësore për respektimin e standardeve të shtetit të së drejtës, jo vetëm garantimin e parimit të ligjshmërisë, por edhe qeverisjen transparente, mbetemi në pritje të informacionit tuaj, brenda afatit ligjor.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin,

**LEONARD OLLI**

KRYETAR

GRUPI KËSHILLTARËVE TË PARTISË DEMOKRATIKE

